UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-13

PËR APROVIMIN E BUXHETIT VJETOR TË KONSOLIDUAR TË KOSOVËS DHE PËRVETËSIMET PËR PERIUDHËN PREJ 1 JANARIT DERI MË 31 DHJETOR 2005

Kuvendi i Kosovës,

Duke pasur parasysh përgjegjësitë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes sipas Kreut 9.1.26 (a), 5.1 (a) dhe (b) dhe Kreut 5.2 (c) të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme;

Duke marrë parasysh autoritetin final të PSSP-së, sipas nenit 8.1 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 të datës 15 maj 2001, të ndryshuar, Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, për aprovimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës,

Miraton:

LIGJIN PËR APROVIMIN E BUXHETIT VJETOR TË KONSOLIDUAR TË KOSOVËS DHE PËRVETËSIMET PËR PERIUDHËN PREJ 1 JANARIT DERI MË 31 DHJETOR 2005

Neni 1
Përkufizimet

Për qëllimet të këtij ligji, janë të përfshirë përkufizimet e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/17 përveç:

Ndarje buxhetore do të thotë shuma ligjërisht e autorizuar e cila mund të vihet në dispozicion për shpenzim nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës për një kategori shpenzimi brenda një programi apo qëllimi të veçantë ose, kur qëllimi i veçantë nuk është identifikuar, për një kategori shpenzimi të një organizate buxhetore, siç është parashtruar në Tabelën 2 të këtij ligji.

Tepricë do të thotë shumat e detyrimeve të pashpenzuara financiare, mjete të veçuara të pashpërndara, mjete të paangazhuara dhe çfarëdo të ardhurash që tejkalojnë shumën e shpenzimeve dhe të detyrimeve të pashpenzuara të bartura nga viti fiskal 2004.

Detyrime do të thotë shpenzime të parapara për të cilat i është dorëzuar Thesarit një urdhërpagesë për detyrimin financiar dhe është evidencuar në Regjistrin Kontabël të Thesarit, pa marrë parasysh se a i nënshtrohet apo jo detyrimit ligjor.

Kategoritë e shpenzimeve do të thotë pagat dhe shtesat, mallrat dhe shërbimet e tjera, subvencionet dhe transferet, shpenzimet kapitale dhe rezervat.

Shpenzime do të thotë pagesa parash prej Fondit të Konsoliduar të Kosovës.

Alokimi i fondeve do të thotë shuma maksimale e shpenzimeve dhe e detyrimeve që mund të bëhen për ndarje të caktuar, sipas kështillës së dhënë një organizate buxhetore në fletëalokimin e fondeve të lëshuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Buxhet i Përgjithshëm i Kosovës do të thotë buxheti i cili përfshin buxhetet e pakonsoliduara të të gjitha organizatave buxhetore të Kosovës në sektorët e aktiviteteve të Qeverisë, që përfaqësohen nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes (duke përfshirë komunat) dhe kompetencat e rezervuara, ndarje të cilat janë paraqitur në Pasqyrën 2 të këti Ligji.

Organizatë buxhetore me kompetenca të rezervuara do të thotë organizatat buxhetore që pranojnë shuma të caktuara sipas Tabelës 2 të bashkëngjitur këtij Ligji.

Mjetet e mbajtura do të thotë shuma të parave të pa ndara që mbeten në Fondin e Konsoliduar të Kosovës deri me 31 dhjetor të vitit fiskal paraprak.

Regjistër Kontabël i Thesarit do të thotë Regjistri Kontabël i themeluar Brenda Thesarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Neni 2
Miratimi i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2005

2.1. Me këtë ligj miratohet Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2005 siç është paraqitur në Tabelën 1. Ky buxhet mund të ndryshohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me anë të një urdhërese administrative, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/17.

2.2. Struktura e vlerësuar e të hyrave në vitin 2005 është 626.2 milion Euro dhe përbëhet nga 529.8 milion Euro të hyra nga tatimet; 61.6 milion Euro të hyra jo tatimore dhe 34.8 milion Euro të hyra vetanake komunale-tabela 1.

2.3. Niveli i ndarjeve për vitin 2005 nga BKK kapë shumën prej 713.9 milion Euro-tabela 2 (a, b, c).

Neni 3
Ndarjet vjetore nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

3.1. Me këtë ligj autorizohet ndarja e mjeteve nga Fond i Konsoliduar i Kosovës për vitin fiskal 2005 siç është paraqitur në Tabelën 2 të këtij ligji dhe shpenzimet e paraqitura si zëra në Buxhetin e Përgjithshëm të Kosovës për qëllime të Qeverisë Qendrore - tabela 2 (a, b, c).

3.2. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresë administrative për të ndryshuar Tabelat e bashkëngjitura këtij ligji në përputhje me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut. nr. 2003/17.

3.3. Ministri i Financave dhe Ekonomisë do të mbajë një regjistër të të gjitha ndarjeve të miratuara, transfereve të ndarjeve ose ndryshimeve të tjera të miratuara gjatë vitit fiskal 2005 përmes Regjistrit Kontabël të Thesarit të plotësuar sipas nevojës me shënime të tjera. Me rastin e rishikimit gjashtëmujor të buxhetit, Ministri i ministrisë për Ekonomi dhe Financa duhet t'i paraqesë, së paku dy herë në vit, Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, Qeverisë dhe Kuvendit raport gjithëpërfshirës, duke cekur hollësisht dhe duke barazuar ndarjet e miratuara të buxhetit fillestar 2005, të gjitha transferet vijuese dhe ndryshimet tjera dhe ndarjet përfundimtare për vitin fiskal 2005, dhe raportin përfundimtar jo më vonë se tre muaj pas mbylljes së vitit fiskal 2005, dhe sipas kërkesës së Përfaqësuesi Special të Sekretarit të Përgjithshëm, dhe Kuvendit të Kosovës.

Neni 4
Përvetësimet buxhetore në Buxhetet Komunale

4.1. Pavarësisht nga neni 2, Përvetësimet buxhetore në Skemën 2, Tabelën C, që bazohen në "të hyrat vetanake komunale", janë të autorizuara vetëm deri në masën në të cilën ato të hyra janë të depozituara në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe të regjistruara në mënyrë të rregulltë në Regjistrin e llogarive të Thesarit.

4.2. Në rastin kur të hyrat nga participimi, pagesat, taksat ose tatimet e mbledhura nga ana e komunës tejkalojnë shumat e ndara të të hyrave në Tabelën C të Tabelës 2 për atë komunë, duhet bërë një ndryshim shoqërues në shumat e ndara në buxhet për atë komunë. Të hyrat e tepërta mund të mos ndahen apo shpenzohen derisa nuk bëhet ndryshim në buxhetin e asaj komune nga ana e Kuvendit Komunal në përputhje me procedurat e përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, të shpalluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17. Çdo ndryshim i tillë në të hyra dhe ndarje evidencohet në Regjistrin e llogarive të Thesarit dhe përfshihet në rishikimin e ardhshëm të Tabelave Buxhetore të miratuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me nenet 2 dhe 3.

4.3. Të hyrat nga pagesat dhe/ose taksat për arsim evidencohen veçmas, ndërsa këto të hyra mund të ndahen dhe shfrytëzohen nga komuna vetëm për qëllime arsimore. Të hyrat nga participimi për kujdesin shëndetësor primar evidencohen veçmas, ndërsa këto të hyra mund të ndahen dhe të shfrytëzohen nga komunat vetëm për qëllime të kujdesit shëndetësor primar.

4.4. Secila Komunë e specifikuar në Skemën 4, do të alokojë për komunitetet jo-shumicë të asaj Komune, nga të hyrat vetanake dhe granti i përgjithshëm, grantet për arsim dhe shëndetësi, të pranuara nga Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës, së paku proporcionin e treguar në Skemën 4, skemë kjo që mund të rishikohet në mënyrë periodike në bashkërendim me Qeverinë e Kosovës dhe Kuvendet Komunale. Rekomandimet e përbashkëta për çfarëdo rivlersim apo rindarje të përqindjeve duhet të dërgohen nga Zëvendës Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Administratë Civile dhe nga Ministri i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa te Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për miratim.

4.5. Shpenzimet për rastet e jashtëzakonshme e rastit nuk përfshihen për qëllime të përllogaritjes të ndarjes së drejtë financiare për vetë arsyen e përkufizimit. Kjo nuk vlen për shpenzimet e rastit të autorizuara veçanërisht për t'i ndihmuar ndonjë komune në përmbushjen e përgjegjësive të saja për ndarje të drejtë financiare.

4.6. Brenda 15 ditësh pas përfundimit të çdo tremujori të vitit fiskal 2005, secila komunë duhet të përgatisë dhe të dorëzojë një raport financiar në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa dhe Zyrës për çështjet e komunitetit lidhur me ndarjen e drejtë financiare dhe standardet e objektivat tjera përkatëse.

4.7. Në rast se Komuna nuk e përmbush proporcionin e përcaktuar të ndarjes së drejtë të financimit, apo nuk vepron në përputhje me standardet dhe kriteret tjera relevante, ZPSSP i Shtyllës II dhe Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave pas konsultimit me Komisionin për Grante mund t'i rekomandojë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (që nga këtu PSSP), implementimin e masave, të cilat mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

(a) Mbajtjen e alokimeve të ardhshme nga Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës, apo nga të hyrat vetanake, deri në kohën kur të përmbushet proporcioni i përcaktuar i ndarjes së drejtë të financimit;

(b) Përcaktimin e kritereve për Komunat për shpenzimin e fondeve në dispozicion;

(c) Bartjen e fondeve të zotuara e të pashpenzuara të komunës për vitin 2004, deri në nivelin e përpjestueshëm me deficitin e shpenzimeve për komunitetet joshumicë në përputhje me përqindjet e përcaktuara në Tabelën 3 të Rregullores nr. 2003/41 të UNMIK-ut, për projekte të posaçme për komunitetet joshumicë në vitin 2005;

(d) Tërheqjen e fondeve komunale drejpërdrejtë për komunitetet jo-shumicë;

(e) De-certifikimin e Komunës në fjalë;

(f) Caktimin e një administratori financiar komunal në bazë të nenit 61 të Ligjit mbi Menaxhimin e Finacave Publike dhe Përgjegjësive, të shpallur me Rregulloren e UMNMIK-ut nr. 2003/17, sipas nevojës.

4.8. Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave në bashkërendim të ngushtë me Zëvendës Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Administratë Civile, pasi të ketë konsultuar Komisionin për Grantet, mund të nxjerrë udhëzime administrative lidhur me administrimin e ndarjes së drejtë të financave nga komunat.

Neni 5
Të hyrat vetanake të Organizatave Qendrore Buxhetore

5.1. Të gjitha të hyrat vetanake për organizatat e qeverisë qendrore, që përbëhen nga tarifat dhe ngarkesat e shfrytëzuesve, por që nuk kufizohen nga të njejtat, do të depozitohen në një llogari speciale në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Për qëllimet e këtij ligji, shprehja "tarifat dhe ngarkesat e shfrytëzuesve" definohet si pagesë e pranuar nga organizata e qeverisë qendrore për dërgesat e mallrave dhe shërbimeve për institucionet jo-qeveritare apo individët.

5.2. Ministri për Financa dhe Ekonomi është i autorizuar të nënshkruajë Memorandumin e Mirëkuptimit me organizatën buxhetore, për të adresuar:

a. Procedurat për vjeljen, bashkërendimin dhe depozitimin e të hyrave në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës

b. Shumën apo proporcionin e të hyrave që do t'i ndahet organizatës buxhetore.

5.3. Organizatat buxhetore do të jenë përgjegjëse për grumbullimin, depozitimin dhe bashkërendimin me Thesarin, në pajtim me procedurat në Memorandumin e aprovuar të Mirëkuptimit. Shuma e ndarjeve të autorizuara nuk duhet të tejkalojnë vlerën e të hyrave të depozituara specifike në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

5.4. Të gjitha ndryshimet në të hyrat dhe ndarjet buxhetore që rezultojnë nga një Memorandum i tillë i Mirëkuptimit do të inkorporohen në rishikimin e ardhshëm të Buxhetit të miratuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 6
Ndarja dhe ri-ndarja e balanceve dhe fondeve nga suficiti i bartur

6.1. Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas lëshimit të ndarjeve të plota buxhetore për vitin 2005, Qeveria i paraqet Kuvendit dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, pasqyrën preliminare, që paraqet shumat totale, burimet dhe shfrytëzimin e elementeve të mjeteve të bartura si bilanc në të gatshme nga viti fiskal 2004, përfshirë këtu:

a) Ato fonde të identifikuara nga Buxheti i vitit 2004, të përfshira në buxhetin e vitit 2005 si fonde të bartura, me qëllim të kalimit në ndarjet e plota buxhetore në të gatshme në vitin 2005,

b) Mjetet e pashpenzuara të të hyrave vetanake komunale,

c) Mjetet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të qeverisë qendrore,

d) Mjetet e pashpenzuara të granteve të përcaktuara të donatorëve,

e) Mjetet e pashpenzuara nga paratë publike të mbajtura nga AKM që kanë të bëjnë me administrimin e Ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe asetet e ndërlidhura, dhe

f) Fondet tjera që do të mbahen si kursime të mbajtura.

6.2. Mjetet e pashpenzuara nga "të hyrat vetanake komunale" nga viti fiskal 2004 dhe më herët, deri në masën sa janë të depozituara në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe të regjistruara në Regjistrin Kontabël të Thesarit si ndarje buxhetore për komunë, janë të ndara dhe të autorizuara për vitin fiskal 2005.

6.3. Mjetet e pashpenzuara të kontributeve të përcaktuara të donatorëve, të cilat janë pranuar dhe regjistruar në Regjistrin Kontabël të Thesarit në vitet 1999- 2004, ndahen dhe autorizohen për vitin fiskal 2005.

6.4. Në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të shpallur me Rregullorën e UNMIK-ut Nr. 2003/17, të gjitha dhuratat, huatë ose kontributet e donatorëve do të depozitohen dhe të konsiderohen si pjesë e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, përveç nëse ndryshe miratohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Pas përfundimit të procedurave të lëshuara nga Departamenti i

Thesarit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhe pas depozitimit në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, përveç nëse ndryshe miratohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, dhuratat, huatë apo kontributet e tilla të donatorëve do të konsiderohen si të ndara për qëllimin ose qëllimet e specifikuara, si dhe do të mund të alokohen dhe të shpenzohen për qëllimin ose qëllimet e tilla.

6.5. Të gjitha paratë publike të mbajtura nga AKM-ja për administrimin e Ndërmarrjeve në Pronësi Shoqërore dhe asetet e ndërlidhura, si dhe çdo pagesë nga Kapitali Statutor i AKM-së janë pjesë e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, në pajtim me Regulloret e UNMIK-ut Nr. 2002/12, 2002/13 dhe 2003/13. Paratë e tilla publike të mbajtura nga AKM-ja do të konsiderohen si të ndara për qëllim(e) specifik(e) të autorizuara sipas ligjit në fuqi, si dhe do të mund të alokohen dhe të shpenzohen për qëllimin ose qëllimet e tilla.

Neni 7
Kufizimet në Zotime dhe Shpenzime

7.1. Shpenzimet apo zotimet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, do të bëhen vetëm:

(a) Nga shuma që është ndarë për këtë qëllim; dhe

(b) Në përputhje me kërkesat e tjera të saktësuara me këtë Ligj dhe nenin 8 të Ligjit mbi prokurimin public.

7.2. Nga çdo organizatë buxhetore kërkohet të garantojë që numri i personelit të saj të punësuar të mos tejkalojë në asnjë kohë gjatë vitit fiskal 2005 numrat e saktësuar në Tabelen 2 të bashkëngjitur këtij Ligji.

7.3. Ministri i Financave dhe Ekonomisë, me këshillë të Ministrit të Shërbimeve Publike, mund të autorizojë rritjen ose zvogëlimin e numrit të personelit të Organizatës buxhetore të saktësuar në Tabelat 2A dhe 2B të bashkëngjitur këtij Ligji. Autorizimi nga ky nen nuk nënkupton as nuk autorizon ndonjë ndryshim në ndarjet për paga, meditje dhe shtesa. Këto ndryshime përfshihen në shqyrtimin e ardhshëm të pasqyrave të buxhetit të miratuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

7.4. Dështimi për të vepruar në pajtim me limitet e numrit të personelit paraqet shkelje të këtij Ligji dhe të Ligjit mbi menagjimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i miratuar si Ligji 2003/2 dhe i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/17. Ndëshkimet e parashikuara me atë ligj do të zbatohen në mënyrë të rreptë për secilin individ që është përgjegjës për një shkelje të tillë.

Neni 8
Shpenzimet e rastit

8.1. Fondet për shpenzimet e rastit ndahen si:

(a) “Rezervë e Ministrit për Financa dhe Ekonomi”, në Tabelën A të Skemës 2; dhe si

(b) “Rezervë e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm”, në Tabelën B të Skemës 2. Shumat e autorizuara për shpenzimet e rastit mund të përdoren vetëm për kërkesat urgjente dhe/apo të paparashikuara.

8.2. Shumat e autorizuara për shpenzimet e rastit mund të përdoren vetëm për kërkesat urgjente dhe/apo të paparashikuara.

8.3. Ministri i Financave dhe Ekonomisë do të dorëzoj një raport tremujor në Kuvend për shfrytëzimin e mjeteve në rastet e jashtëzakonshme.

8.4. Shumat mund të transferohen nga ndarjet e shpenzimeve të rastit, në përputhje me kriteret në vijim:

(a) Transferet e shumave prej më pak ose baraz me 250,000 €, nga "Rezerva e Ministrit të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa ", do të autorizohen nga Ministri i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, pas marrjes së arsyetimit adekuat;

(b) Transferet e shumave prej më shumë se 250,000 € nga "Rezerva e Ministrit të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa " do të autorizohen nga Ministri i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, pas marrjes së arsyetimit adekuat dhe pas aprovimit nga ana e Qeverisë; dhe

(c) Transferet e shumave nga "Rezerva e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, do të autorizohen nga PSSP.

Neni 9
Transferi i shumave të ndara

9.1. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, pas konsultimeve me Qeverinë, mund të autorizojë një transferim të shumave të ndara ndërmjet tabelave të Tabelës 2.

9.2. Ministri i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, nëse ka një arsyetim valid nga Udhëheqësi i organizatës buxhetore, mund të autorizojë transferimin e një pjese të një ndarjeje për atë organizatë buxhetore në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore në përputhje me nenin 27 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut.nr. 2003/17.

9.3. Pavarësisht nga neni 9.2, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm pas kërkesës së Organizatave Buxhetore të Fuqive të Rezervuara mund të autorizoj transferin e shumës më të lartë se njëzetë përqind (20%) të ndarjës negativisht të ndikuar të asaj organizate, pas konsultimit me Ministrin e Financave dhe Ekonomisë.

9.4. Pas miratimit duhet të bëhet përmirësim i shumave të ndara me Tabelën 2, në Regjistrin Kontabël të Thesarit nga ana e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Këto ndryshime duhet të përfshihen në rishikimin e ardhshëm të buxhetit të miratuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 10
Shpenzimet dhe të Hyrat e Ndërmarrjeve Publike

Në përputhshmëri me nenin 44.4 të Ligjit mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, dhe varësisht prej aprovimit nga ana e Qeverisë, Kuvendit dhe PSSP-së, fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës mund të shfrytëzohen për të siguruar hua të përkohshme për Entitete të caktuara, nëse huat e tilla janë në përputhshmëri me kushtet e marrëveshjes e cila aprovohet nga Qeveria dhe PSSP-ja.

Neni 11
Skadimi i ndarjeve buxhetore dhe alokimeve

Përveç në rastet kur Ligji i tanishëm mundëson ri-ndarjen, ndarjet buxhetore dhe alokimet e fondeve të bëra gjatë vitit fiskal 2005, do të skadojnë automatikisht në mesnatë, më 31 dhjetor 2005, përveç nëse PSSP-ja autorizon ndryshe në raste të jashtëzakonshme dhe në bazë të kërkesës së Qeverisë.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes nga PSSP-ja.

Ligji Nr. 02/L-13
23 shkurt 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

akademik Nexhat Daci

Tabela 1 Buxheti i përgjithshëm i Kosovës 2005

Tabela 2 Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës

A: Organizatat buxhetore të Qeverisë së përkohshme
B: Organizatat buxhetore të Fushave të Rezervuara
C: Organizatat buxhetore që janë Komuna
D: Përmbledhje e ndarjeve
Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës – Përmbledhje

Tabela 3 Proporcionet që do të përdoren nga Komuna e Specifikuar me qëllim të alokimit të fondeve sipas parimeve të ndarjes së drejtë të financimit.